



TEL: +38349510007 dhe +38344364106

e mail: kosovajudo@hotmail.com

Prishtine, me 20.12.2016

Strategjia e zhvillimit te sportit te xhudos ne Ciklin Olimpik 2016-2020

Strategjia e zhvillimit te Sportit te xhudos ne periudhen 2016-2020 nga federata jone duke u bazuar ne seriozitetin e punes ne periudhen e pasluftes e marr parasysh te arriturat sublime deri te medalja e arte Olimpike do perqendrohet ne disa shtylla kryesore te avancimit ne zhvillimin e sportit te xhudos.

Shtyllat kryesore per zhvillim jane :

1.Masovizimi i sportit te xhudos

- 1.1 Hapja e klubeve te reja
- 1.2 Projekti “ Xhudo neper shkolla “
- 1.3 Projekti Xhudo si rekreacion
- 1.4 Projekti per Persona me aftesi te kufizuara

2.Infrastruktura per sportin e xhudos

- 2.1 Ndertimi i Qendres Nacionale te xhudos dhe Qendrave regjionale te xhudos
- 2.2 Pajisja me tatami te shkollave fillore dhe te mesme dhe

3.Sporti Elitar

1.Masovizimi i sportit te xhudos

1.1 Hapja e klubeve te reja

Marr parasysh interesimin e femijeve dhe te rinjve per sportin e xhudos e duke pas parasysh popullaritetin e garuesve tone qe sot jane heronj te vendit tone sidomos Kampiomja Olimpike Majlinda Kelmendi federate jone pas Lojerave Olimpike ka punuar shume seriozisht ne masovizimin e sportit dhe rritjen e numrit te klubeve dhe seksioneve ne kuader te klubeve.

Numri I klubeve per nje periudhe te shkurte eshte dyfishuar dhe tani kemi 15 klube me nje numer disa here me te madh te xhudisteve ne Kosove e ku aktualisht mungesa e palestrave dhe tatamive neper shkolla fillore po e pengon ne mase te madhe zhvillimin ne masen cfare e deshirojme me gjithë interesimin e madh.

Federata e xhudos se Kosoves ne projektin e rritjes se numrit te klubeve eshte perkrah nga Federata Boterore dhe Evropiane me tatami kurse nepermes kurseve per trener per aftesim dhe licencim te kuadrove pervec licencimit Brenda federates,eshte realizuar kursi per trener me ekspert nderkombetar dhe prej nga jane licencuar nga KOK dhe IOC 25 trener pikrisht per shkollen baze.

Caku i hapjes se klubeve te reja deri ne vitin 2020 eshte 25-30 klube ne kete drejtim parashohim qe synimi te arrihet prej :

1.Federata

2.MKRS me pajisje

3.KOK me licencim te trenereve ne nivele me te avancuara dhe pajisje

4.EJU dhe IJF

5.Komunat me lejimin e shfrytezimit te sallave te shkollave fillore pa pagese ose me pagese ate perballueshme si dhe me avancim te perkrahjes se klubeve me subvencionim

1.2 Projekti Xhudo neper shkolla

Ne vitin 2016 ne vizitat ne shkolla fillore duke realizuar Projektin “ Xhudo neper shkolla” ne bashkepunim me Shkolla fillore ne Prishtine,Prizren dhe Peje ku pjesemarres ishin rreth 20 mije femijeme nje organizim te shkelqyeshem nga federate jone ne bashkepunim me Drjetor

te shkollave fillore tek te cilet kemi hasur ne mirekuptim dhe perkrahje te jashtezakonshme ku kemi promovuar sportin tone me ore praktike dhe teorike qe u mbajten nga Kampionja Olimpikë me trenerin e saj dhe ku femijet ishin te ngazellyer me njohjen e sportit te xhudos e kjo sidomos nepermes heroines sone Majlindes.

Qellimi I ketij projekti ishte qe Sporti I xhudos gradualisht te futet ne Sistemin edukativ neper shkolla sic jane praktiket ne shume shtete ne Evrope.

Per sportin e xhudos nje hulumtim nga UNESCO e rendit ne sportin numer nje per femije 4 plus dhe ate me arsytimin se zhvillon femijet fizikisht ne menyre te rregullt,si dhe forcon nepermes sportit te xhudos aftesite psiko motorike te femijeve.

Ne parim ne qytetin e Pejes me institucionet komunale jemi dakorduar qe gjate ciklit 4 vjecar 2016-2020 te filloj si pilot projekt qe xhudo te jete sport ne sistemin edukativ per klasat 1-5 dhe ne kete drejtim federata tashme ka pergatitur kuadro profesional per kete projekt.

Caku per realizimin e ketij projekti pritet te vjel frutat e punes dhe ate me perfshirje te cdo Qendre regjionale me perkrahjen edhe te Ministrise se Arsimit dhe ate me realizimin e punesimit ne 7 Qendra regjionale te kuadrove profesionale te xhudos te cilet duhet te jene me arsimim te larte Universitar ne edukaten fizike por edhe kuadro profesionale sipas kriterave te federates per pune me gjenerata te reja.

Perfitimi per sportin e xhudos do ishte shume serioz marr parasysh qe me dhjetera mijera femije do kalonin ne duart e kuadrove profesionale dhe kesisoj identifikimi I talenteve dhe rrjedhimisht derguarja e tyre te stervisin neper klube do ishte shume me I madh dhe me produktiv.

Kosto financiare per realizimin dhe futjen ne system edukativ nuk eshte shume e madhe sepse nuk do kerkonte per fillim me shume se 15 te punesuar,e marr parasysh sukseset besojme qe xhudo ne Kosove duhet te shihet me prioritet sa I perket sporteve.

1.3 Xhudo dhe rekreacioni

Sporti I xhudos mund te mburret si nje nder sportet qe stervitet deri ne moshat e shtyera dhe rrjedhimisht sport I cili ka te zhvilluar sistemin e garave per Veteran si forme rekreacioni dhe ate duke filluar prej moshes 30 vjecare deri ne moshen 80 vjecare.

Per veteran federate Evropiane dhe Boterore organizojne edhe gara dhe ate me system per veteran ne grupmosha prej 30 -35 vjec 35- 40 vjec.,40-45 vjec,45 – 50 vjec,50-55 vjec,55-60 vjec e ma tutje deri ne moshen mbi 80 vjecare,kjo forme rekreative ju jep mundesi njerezve qe me sportin e xhudos te merren deri ne moshen e shtyer qe eshte e rendesishme per shendetin e njeriut.

Caku I federates eshte perfshirja e sa me shume njerezve te merren me sport ne menyre rekreative dhe ne kete drejtim ne disa klube edhe jane hapur seksione per rekreacion dhe ate 2 ose 3 here ne jave me tendence qe kjo praktike te realizohet ne cdo klub e pse jo edhe hapja e klubeve te xhudos per rekreacion.

Perfshirja ne menyre te organizuar dhe nepermes federates e xhudos ne Polici,Ushtri dhe universitete e ku federate me kenaqes do asistoj me kuadro e sidomos per polici dhe ushtri marr parasysh qe xhudo aplikon edhe xhudon si vetembrojtje lami qe duhet njohur cdo polic dhe ushtar ne shtetin tone.

1.4 Projekti per Persona me aftesi te kufizuara

Xhudo eshte nje nder sportet me te perhapura ne bote dhe shume lehte per tu mesuar.

Eshte sport I pershtatshem per te gjithë grupmoshat nga femjet e deri tek personat me te moshuar, praktikohet shume ne mbare boten nga persona me aftesi te kufizuara dhe madje ka edhe gara te tilla si,gara per persona me shikim te demtuar,per persona me sindrom Down etj.

Xhudo eshte sporti I vetem nga sportet luftarake qe eshte pjese e Lojerave Paraolimpike.

Ne lojera Paraolimpike marrin pjese vetem sportistet me shikim te demtuar te cilet ndeshen nejt sikurse garuesit ne sporte olimpike perveq se e fillojne ndeshjen te kapur me njeri tjetrin.

Qellimi I Federates sone do te jete krijimi I programeve te veqanta per persona me aftesi te kufizuara dhe perfshirja e tyre ne sportin e xhudos.

2. Infrastruktura per sportin e xhudos

2.1 Ndertimi i Qendres Nacionale te xhudos dhe Qendrave regjionale te xhudos

Marr parasysh qe ska politikan qe nuk mburret me te arriturat e sportit te xhudos dhe e gjithë kjo fal sukseseve te garuesve tone ateher eshte e pakuptimte qe deri tash asnje objekt i specializuar per xhudo seshte ndertuar.

Pas kthimit nga Lojerat Olimpike kerkesa e pare e ekipit tone me medalje te arte te fituar ishte ndertimi I Qendres Nacionale te xhudos dhe ate ne qytetin e Kampioneve ne Peje.

Ky mesazh mori perkrahje nga Qeveria dhe poashtu edhe KK Peje qe ndau parcelen per ndertim ne qytetin e Pejës projekt ky shume serioz dhe i cili procedurat ligjore I ka tejkaluar dhe ka mbetur edhe fillimi I ndertimit ne praktike me shprese qe diku ne vitin 2019 ky projekt te perfundoj.

Qendra Nacionale e cila si projekt I cili ka marr forme do jete nje nder objektet me modern ne shtetet e regjionit per xhudo dhe me shprese per mos neglizhim te procedurave ky objekt do jete krenaria e federates sone apo rrumbullakesim I nje pune te madhe qe pos sukseseve ne arena sportive sporti yne te arrij edhe sukses ne ndertimin e te ardhmes me infrastructure modern si kusht I rendesishem per kontinuitet te rezultateve.

Takimet e federates me udheheqes Komunal kan rezultuar edhe me nje premtim nga Kryetari I Fushe Kosoves qe eshte zotuar per ndarje te parceles por edhe ndertim te palestres per xhudo ne kete komune por kjo per momentin ende ska marr forme si projekt, gjithcka eshte ne fazen preliminare.

Pas Qendres Nacionale caku eshte qe ne Komuna te medha te ndertohen Dojo qe do ishin ne shfrytezim si Qendra regjionale dhe ne kete forme sporti I xhudos do merrte vendin e merituar marr parasysh mundesite e sukseseve ne nivele elitare.

2.2 Pajisja me tatami te shkollave fillore dhe te mesme

Infrastruktura ekzistuese per pune te klubeve te vogla neper palestra te shkollave fillore dhe te mesme po paraqitet si zgjedhje e mire per masovizim marr parasysh qe palestra neper shkolla pothuajse kemi ne secilen shkolle ne shtetin tone dhe ne si federate do tentojme qe

me futjen e xhudos ne sistemin edukativ te kemi pajisjet e duhura per xhudo neper shkolla e kjo tash per tash eshte problem me I madh per hapje te klubeve e seksioneve te reja.

Problem tjetër që po paraqitet neper Komuna eshte pagesa që po kerkohet per shfrytezimin e palestrave shkollore e kjo duke ditur se ne cfare veshtiresi financiare jane klubet ne cdo sport po dergon shume klube ne mbylljen e klubeve.

Ky problem dhe pagesa te larta kemi sidomos ne Komunen e Prishtines e ku klubet e xhudos nuk po munden te mbijetojne,dhe si pasoje e kesaj ne kryqytet e kemi vetem nje klub që stervit ne nje shkolle fillore dhe me shume veshtiresi po perballon koston e pageses!

Kryeqyteti po paraqitet si vendi I pafavorshem per zhvillimin e xhudos dhe si rrjedhoj kemi vetem dy klube e që per ne eshte shume numer I vogel kur te kihet parasysh që ne qytetin e Pejës kemi 5 klube e afer dhjete seksione te xhudos.

Caku per kete projekt :

1.Pajisja neper Komuna e se paku 2 shkollave fillore me tatami

2.Marreveshja me Kryetar te Komunave që ne keto shkolla te mos paguhen terminet

3.Federata,KOK,MKRS,Ministria e arsimit ne Ciklin 2016-2020 te pajisin me tatami fillimisht ne 7 Qendrat Regjionale nga 2 shkolla fillore per te vazhduar tutje me pajisjen e shkollave fillore ne secilen Komune realizimi i ketij projekti xhudon do e bej pikerisht ate që meriton

sport me prioritet marr parasysh edhe talentin që te rinjte tane kane per arritje te rezultateve kulminante.

3.Sporti elitari

Cikli Olimpik 2012 -2016 mund te shkruhet si Cikli Olimpik I pare per shtetin tone te ri por nese shikohen sukseset ateher eshte periudha me e shendritshme e sportit te te gjitha koherave per Kosoven dhe jo vetem.

Medalja e arte Olimpike si e arritura me e madhe e te gjitha koherave ne sport eshte arritur nga sportistja jone e duke bashkangjitur edhe dy medalje te arta nga Boterori qe prape jane te vetmet ne historine e sporti te Kosoves poashtu edhe2 tituj te Kampioni Evropian,medalja e pare dhe e vetme nga Lojerat Evropiane e shume medalje te tjera bejne qe federate jone ne 4 vitet e fundit te shenoj me shkronja te arta me te arriturat sublime emrin e shtetit tone te ri.

Xhudo me suksese ne Sportet Olimpike e te cilat ne fakt edhe jane vlera ne sport ka shkuar aq larg sa qe edhe shume shtete te fuqishme Boterore do na kishin lakmi.

Sporti I xhudos sot eshte sport ne ekspansion te hatashem,prandaj edhe mbetja ne trend me suksese kulminante eshte sfide e veshtire dhe pune e jashtezakonshme.

Qellimi I federates tone ne ciklin Olimpik 2016-2020 eshte qe te rritet numri i garuesve me medalje Elitare per te rritur dhe per te rinj.

Plani dhe program I punes me gjenerata te reja per arritje elitare do konsolidohet duke funksionalizuar qytetin e Pejes si qender Nationale e xhudos dhe fillimisht kemi filluar me 2 garues nga klubi Trepca e Mitrovices si pilot projekt dhe menjeher ka ardh suksesi sepse kemi edhe medaljen e pare Evropiane per kadet nga garues qe jane jashte qytetit te Pejes.

Ky projekt do te rritet dhe do jete me gjithperfshires me Ndertimin e qendres nacionale ne Peje marr parasysh kushtet qe do krijohen per pune,akomodim dhe infrastructure tjeter per ardhjen e garuesve te talentuar nga qytete tjera per te punuar seriozisht.

Per Lojerat Olimpike ne Rio xhudo ka fituar dy Norma Olimpike kurse per Tokyo 2020 qellimi eshte 4-5 Norma Olimpike si dhe medalje Olimpike.

Strategjia per rezultate kulminante eshte competence e Drejtorit sportiv dhe kerkesa jone si federate eshte qe te ndertohet nje shtab teknik I qe do jete ne dispozicion te tij sepse ekipi per te arritura Kulminante per dallim nga Cikli 2012-16 e qe ka qene 4-5 garues tani kemi hic me pak se 15 garues me potencial per rezultate kulminante prandaj eshte e pamundur qe te punohet pa ekip serioz.

Planifikohet qe Drejtori te kete se paku tre asistente me pagese,me shprese qe Ministria,KOK,Sponsor etj te mendojne se prej nga e si eshte arritur suksesi me I madh I shtetit tone jo vetme ne sport por jo vetem.

Pra qellimi I Federates sone per ciklin 2016-2020 do te jete vazhdimesia e sukseseve te arritura deri me tani ne gara Kampionale,ngitja e performances se garueseve nga niveli mesatar ne nivel elitar e kjo permes arritjeve te rezultateve ne Kampionatet Evropiane,Lojerat Evropiane,Kampionatet Boterore dhe Lojerat Olimpik.

Sistemi I punes per cikel 4 vjecar per Sportist elitar I federates tone tani me po hyn ne ciklin e trete Olimpik marr parasysh qe edhe per Lojerat Olimpik 2012 kemi arriutr Normen Olimpik per shtetin tone edhe pse IOC sna lejoj te marrim pjese per shtetin tone per Lojerat Olimpik 2016 kemi arritur 3 Norma Olimpik dy ne te njejten kategori si dhe medaljen e arte Olimpik kurse per Lojerat Olimpik 2020 4-5 Norma dhe medalje Olimpik.

Per arritjen e qellimeve per kete cikel Olimpik mbeshtetja pritet si vijon :

- 1.Federata me staf professional por edhe mbeshtetje financiare per ushqim dhe vitaminizim te ekipit Olimpik**
 - 2.KOK- me Bursa Olimpik nga Fondi I solidaritetit,financim te pergatitjeve per ekipin Olimpik sidomos ne Japoni ku kosto eshte e madhe dhe planifikohen ne 2 vitet e fundit para Olimpiades,**
 - 3.MKRS – me Kategorizim te sporteve dhe sportistev e trenereve,dhe duke aplikuar politika serioze per federaten tone se ciles I duhet shtab teknik professional per te ecur tutje drejt medaljes ne Lojera Olimpik**
 - 4.EJU- Federata Evropiane me programin EJU Support per OTC projekt ky qe federaten tone do e ndihmoj shume dhe qe EJU-s I kemi sjellur medalje te arte nga Olimpiada e qe e ben Federaten Kontinentale me te sukseshme te LO 2016.**
 - 5.IJF- si perkrahese e madhe e federates tone e cila gjithmone projektet e federates I ndihmon me aq sa mundet prandaj shpresojme te kemi edhe ne kete cikel perkrahjen e tyre Nese realizohen pritet per te kompletuar kete strategji me protagonistet e cekur me larte atehere besojme qe xhudo e Kosoves do rritet dhe do luaj rol me rendesi ne xhudon Evropian dhe Boterore.**
- Strategjia e zhvillimit te xhudos u punua nga ekipi professional per zhvillimi e xhudos ne Kosove I emeruar nga Kryetari I federates dhe u aprovua nga Bordi I federates,dhe si I tille paraqet sfidat per federaten ne ciklin Olimpik deri me 2020.**

**Kryetari
Agron Kuka**